



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### KONSTATIME të Komitetit për Politikë dhe Financa, të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 27 shtator 2023

Fillimisht pas procesit të votimit njëzëri mbështeten propozimet e paraqitura nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe financave z. Fatlum Osmani që të përfshihen në kuadër të rendit të ditës si pika shtesë dhe atë:

- **Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës( në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).**  
*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.*
- **Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “ Furnizim me mëshqerra “**  
*Me 6 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.*
- **Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës**  
*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.*
- **Propozim vendimi - materiali nga pika e 9 e rendit të ditës për shkak të një gabimi teknik të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026 & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026**  
*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota u miratua propozimi -që propozim vendimi - materiali nga pika e 9 e rendit të ditës të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje - draft Strategjia dhe Plani i veprimit lokal për dhunën në familje 2023-2026.*

**-Kryesuesi i Kuvendit propozoi që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkollli.**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.*

**1.Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**2. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri**

*Me 5 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**3. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024**

*Me 6 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajturi rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**4. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF Raporti nga diskutimi publik**

*Me 6 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajturi rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**5. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 & Raporti nga diskutimi publik**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**6. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**7. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal- POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**8. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së).**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**10. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri Për projektin “Furnizim me mëshqerra “**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**11. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

**12. Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkolli.**

*Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim*

Nr. prot. 016/01-0071288/23  
Podujevë, datë: 26.09.2023

